

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA GABA KUNDËR SHQIPËRISË
(kërkesa nr. 33369/17)

VENDIM

Neni 6 § 1 (civil) – Gjykim i drejtë – Shqyrtim i posaçëm dhe prishje e vendimit të formës së prerë të komisionit të rikthimit të pronave, që i akordoi kërkuarit një truall, të pajustificuar nga rrethana thelbësore dhe bindëse – Shkelje e parimit të sigurisë juridike

Përgatitur nga Regjistri. Nuk detyron Gjykatën.

STRASBURG
17 dhjetor 2024

Ky vendim do të bëhet përfundimtar sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Gaba kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Ioannis Kistakis, *kryetar,*

Lutfi Hüseyinov,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir,

Diana Kovatcheva,

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 33369/17) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), më 2 maj 2017, nga një shtetas shqiptar, z. Hasan Gaba (kërkuar);

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (Qeveria) për kërkesën;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 26 nëntor 2024,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me një kërkesë bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, sipas së cilës autoritetet vendase kishin anuluar një vendim të formës së prerë të komisionit të pronave pa paraqitur rrethanat thelbësore dhe bindëse që e kishin shkaktuar atë masë.

FAKTET

2. Kërkuar ka lindur në vitin 1940 dhe ka banuar në Tiranë. Ai u përfaqësua në Gjykatë nga z. B. Asllani, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë. Pasi kërkuar ndërroi jetë më 18 nëntor 2018, trashëgimtarët e tij, znj. Hysnie Mahmuti, znj. Melaize Ruli dhe znj. Lale Meçi, shprehën dëshirën të vijonin procedimet në emër të kërkuarit.

3. Qeveria u përfaqësua nga Agjenti i saj i asaj periudhë e znj. B. Lilo, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbledhen si në vijim.

I. LEJA E NDËRTIMIT PËR NJË PIKË TRANSMETIMI RADIOTELEVIZIVE

5. Më 2 shkurt 2000, autoriteti përkatës lëshoi një leje ndërtimi për Transmetuesin Publik Shqiptar (TVSH – “Transmetuesi publik”) për ndërtimin e një pike transmetimi radiotelevizive në një sipërfaqe toke kullotë në Lazarat.

II. PROCEDURAT NË LIDHJE ME ISH-PRONËSINË E TOKËS

6. Në një datë të paspecifikuar, me shumë mundësi në vitin 2003, kërkuesi paraqiti një padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër, me anë të së cilës kërkonte t’i njëhej një ngastër e kullotës malore që kishte qenë në pronësinë e babait të tij në vitin 1945, dhe më pas ishte shpronësuar prej tij nga autoritetet e regjimit komunist.

7. Kërkuesi parashittoi se ai kishte depozituar një padi në gjykatë, dhe jo një kërkesë për rikthim pranë Komisionit për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave Gjyrokastër (“Komisioni” – shih paragrafin 43 më poshtë), sepse ai nuk zotëronte të dhëna të mjaftueshme me shkrim dhe arkivore për të përmbushur kërkesat e Komisionit në lidhje me standardin e provës.

8. Gjykata e Rrethit Gjyrokastër konstatoi se një vendim i vitit 1998 i Komisionit, dhënë për një ngastër toke ngjitur, i referohej ngastrës së kërkuesit, se i perkiste familjes së kërkuesit. Gjithashtu, gjykata shqyrtoi një marrëveshje të vitit 1945, përmbajtja e së cilit nuk përshkruhej në vendimin e Komisionit, që mbështeste po ashtu pretendimin se ngastra e tokës i kishte përkitur babait të kërkuesit. Së fundmi, gjykata dëgjoi tre dëshmitarë të cilët deklaruan se toka në fjalë i kishte përkitur babait të kërkuesit.

9. Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave Gjyrokastër u emërtua si i pandehuri në proces për faktin se ai ishte autoriteti shtetëror përgjegjës për tokën atë periudhë. I padituri u përfaqësua nga një avokat nga Avokatura e Shtetit dhe e la çështjen në diskrecionin e gjykatës.

10. Më 17 dhjetor 2003, Gjykata e Rrethit Gjyrokastër e pranoi padinë dhe deklaroi se babai i kërkuesit kishte qenë pronari i tokës (vendimi i vitit 2003). Në një datë të paspecifikuar, sekretari i gjykatës i shtoi vendimit një klauzolë përfundimtare ku deklaronte se nuk ishte depozituar asnjë ankesë ndaj vendimit, dhe se vendimi ishte bërë i formës së prerë më 5 janar 2004.

III. PROCEDURAT NË LIDHJE ME RIKTHIMIN E TOKËS

11. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesi paraqiti një kërkesë për rikthimin e pronës pranë Komisionit, ku kërkonte që t’i rikthehej kullota malore që i kishte përkitur babait të tij.

12. Pas një vizite në terren, Komisioni konstatoi se në ngastrën e tokës në fjalë gjenden katër antena. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se pika e transmetimit radiotelevizive (shih paragrafin 5 më sipër) nuk ishte ndërtuar ende.

13. Më 20 shkurt 2006, në mbështetje të vendimit të vitit 2003, Komisioni konstatoi se toka kullotë prej 335 hektarësh (toka) i kishte përkitur babait të kërkuesit dhe vendosi që t’ia rikthente kërkuesit (vendimi i vitit 2006).

14. Seksioni 5 i klauzolës operative të vendimit parashikonte një afat tridhjetëditor brenda së cilit mund të depozitohet një ankesë. Në një datë të paspecifikuar, kryetari i Komisionit shtoi në vendim një klauzolë përfundimtare, duke e shpallur vendimin të formës së prerë më 20 mars 2006.

15. Më 2 maj 2006, Komisioni dhe kërkuesi nënshkruan një procesverbal dorëzimi, ku deklarohet se kërkuesi kishte marrë pronësinë e tokës.

16. Më 29 qershor 2006, Zyra e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme regjistroi titullin e pronësisë së kërkuesit ndaj tokës dhe i dorëzoi dokumentacionin përkatës (*vërtetim nga dokumenti hipotekor*).

IV. MASA PËR TË LIRUAR TOKËN

17. Në një datë të papërcaktuar, në mbështetje të vendimit të vitit 2006, kërkuesi paraqiti një padi ndaj transmetuesit publik dhe një sërë kompanish private telekomunikacioni, ku i kërkonte atyre që të hiqnin antenat nga toka e tij (shih paragrafin 12 më sipër).

18. Më 6 prill 2009, transmetuesi publik informoi Avokaturën e Shtetit se ishte paditur nga kërkuesi. Gjithashtu, ai i kërkoi Avokaturës së Shtetit që të niste shqyrtimin e vendimit të vitit 2006, sipas nenit 5 të ligjit për Avokaturën e Shtetit (ligji nr. 10018, i datës 13 nëntor 2008 – shih paragrafin 42 në vijim), sipas së cilit Avokatura e Shtetit mund të ndërmerre procedime për rishikimin e vendimeve të formës së prerë.

V. RISHIKIMI I VENDIMIT TË VITIT 2006

A. Vendimi i Agjencisë për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave

19. Më 7 maj 2009, Avokatura e Shtetit paraqiti një ankesë ndaj vendimit të vitit 2006 pranë Agjencisë për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia), që ishte një autoritet administrativ që kishte pasuar Komisionin (shih paragrafin 45 në vijim). Gjithashtu, më 15 qershor 2009, drejtori i Agjencisë vendosi të ushtronte të drejtën e tij të posaçme për të shqyrtuar vendimin e vitit 2006 me propozimin e tij (shih paragrafin 49 në vijim). Të dyja masat u vendosën në të njëjtën dosje.

20. Më 25 maj 2010, Agjencia anuloi vendimin e vitit 2006.

21. Agjencia konstatoi se Komisioni, pa asnjë shpjegim, i kishte dhënë kërkuesit një sipërfaqe më të vogël toke sesa ajo e referuar në vendimin e vitit 2003. Gjithashtu, Agjencia konstatoi një sërë problematikash me dokumentet në dosjen e çështjes: i. hartat e tokës nuk ishin përpiluar nga një profesionist i licencuar; ii. disa pjesë të hartave të tokës ishin ngjyrosur në të verdhë pa asnjë shpjegim; iii. raporti në terren nuk ishte nënshkruar nga një anëtar i Komisionit; dhe iv. vendimi i vitit 1998 i Komisionit i shqyrtuar nga, dhe sipas, Komisionit nuk shoqërohej me një hartë.

22. Gjithashtu, Agjencia konstatoi se rezultonte një mbivendosje midis tokës së kërkuesit dhe pronës së zotëruar nga transmetuesi publik, dhe Komisioni e kishte injoruar atë problematikë.

23. Gjithashtu, Agjencia konstatoi se nuk kishte të dhëna mjaftueshme për të provuar se babai i kërkuesit e kishte pasur ndonjëherë në zotërim atë tokë. Veçanërisht, sipas këndvështrimit të saj, vendimi i vitit 2003 kishte autoritet të kufizuar, pasi ishte marrë sipas një procedure specifike për “konstatimin e një fakti juridik provat dokumentare të të cilit ishin zhdukur” (shih *Marku kundër Shqipërisë*, nr. 54710/12, §§ 19 dhe 37, 15 korrik 2014, dhe *Bici kundër Shqipërisë*, nr. 5250/07, § 51, 3 dhjetor 2015 për kontekst).

24. Në lidhje me marrëveshjen e vitit 1945, Agjencia konstatoi se ajo nuk ofronte mjaftueshëm detaje për të provuar se babai i kërkuesit kishte zotëruar tokën. Pjesa tjetër e materialeve në dosjen e çështjes u konstatua të ishte po ashtu jo bindëse.

25. Së fundmi, Agjencia konstatoi se vendimi për t’i rikthyer kërkuesit tokën, në vend që t’i akordohej kompensim, ishte e pabazuar, sepse prania e antenave të telekomunikacionit dhe televizioneve te kjo tokë nënkuptonte se toka po shërbente për një interes publik.

B. Gjykata e Rrethit Tiranë

26. Kërkuesi kundërshtoi vendimin e Agjencisë, duke argumentuar se: i. pushteti i Agjencisë për të shqyrtuar me nismën e saj dhe për të anuluar vendimet e komisioneve të pronave ishte shpallur jo kushtetues pasi shkelte kërkesën për siguri juridike (shih paragrafët 52–56 në vijim); dhe ii. në çdo rast, ai kishte paraqitur mjaftueshëm prova për të provuar se toka kishte qenë në pronësinë e babait të tij.

27. Më 9 dhjetor 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi kundërshtimin. Kjo gjykatë konstatoi se vendimi i vitit 2006 nuk ishte “anuluar”, por ishte ndryshuar pas një ankese nga Avokatura e Shtetit (shih paragrafin 19 më sipër).

28. Gjithashtu, gjykata konstatoi se kërkuesi nuk kishte paraqitur mjaftueshëm prova për të provuar se babai i tij e kishte pasur tokën në pronësi.

C. Gjykata e Apelit Tiranë

29. Kërkuesi paraqiti një ankesë. Më 18 tetor 2012, Gjykata e Apelit Tiranë ndryshoi vendimin e gjykatës më të ulët dhe vendosi në favor të kërkuesit.

30. Gjykata konstatoi se pushteti i Agjencisë për të shqyrtuar dhe anuluar vendimet e formës së prerë të komisioneve ishte shpallur jo kushtetues nga Gjykata Kushtetuese, dhe pronësia e kërkuesit ndaj tokës u mbështet në të dhëna të mjaftueshme dhe në Ligjin për Pronën të vitit 2004 (ligji nr. 9235, i datës 29 korrik 2004, i ndryshuar).

D. Gjykata e Lartë

31. Më 18 shkurt 2016, Gjykata e Lartë ndryshoi vendimin e gjykatës së apelit dhe la në fuqi vendimin e shpallur nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

32. Së pari, ajo konstatoi se kërkuesi nuk kishte mundur të provonte se babai i tij e kishte zotëruar tokën.

33. Së dyti, ajo konstatoi se vendimi i vitit 2006 nuk ishte bërë asnjëherë i formës së prerë dhe detyrues, pasi Avokatura e Shtetit kishte paraqitur një ankesë ndaj tij brenda afatit. Sipas rrethanave, gjykata arriti në përfundimin se nuk ishte ngritur asnjë problematikë në lidhje me sigurinë juridike.

34. Në seksionin e ligjit të zbatueshëm të vendimit të saj, Gjykata e Lartë citonte nenin 18, të Ligjit të Pronës 2004 (ndryshuar dhe riformuluar në vitin 2009 – shih paragrafin 50 në vijim), që i bënte të mundur Avokatit të Shtetit të kundërshtonte vendimet e Agjencisë brenda tridhjetë ditëve nga dita e njoftimit.

E. Gjykata Kushtetuese

35. Më 6 shtator 2016, kërkuesi paraqiti një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese.

36. Për sa ka të bëjë me çështjen, ai argumentoi se titulli i pronësisë së babait të tij ndaj tokës ishte dhënë me anë të një vendimi të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër në vitin 2003, dhe, me neglizhimin e atij vendimi, Gjykata e Lartë kishte shkelur parimin e *res judicata*.

37. Kërkuesi shtoi se Gjykata e Lartë nuk kishte vepruar si një gjykatë e orientuar nga ligji, sepse ajo kishte rishqyrtuar provat në dosjen e çështjes, gjë e cila nuk ishte detyra e saj sipas ligjit vendas.

38. Gjithashtu, sipas këndvështrimit të kërkuesit, Gjykata e Lartë kishte gabuar qartazi me konstatimin e saj se vendimi i vitit 2006 nuk ishte bërë i formës së prerë.

39. Së fundmi, ai i referohej gjerësisht praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e vendimeve të formës së prerë të komisioneve (shih paragrafët 52–56 në vijim), dhe ankohej se anulimi i vendimit të vitit 2006 kishte shkelur parimin e sigurisë juridike.

40. Më 2 nëntor 2016, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën. Ajo konstatoi se Gjykata e Lartë nuk kishte vijuar me rishqyrtimin e provave në dosjen e çështjes, por nuk e kishte shkelur Kushtetutën. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese deklaroi se detyra e saj ishte e kufizuar për të shqyrtuar pretendimet për shkeljen e Kushtetutës, dhe jo të ligjeve të zbatueshme në një mosmarrëveshje civile.

LIGJI I BRENDSHËM DHE PRAKTIKA GJYQËSORE KUSHTETUESE PËRKATËSE

I. KODI I PROCEDURËS CIVILE

41. Neni 388 i Kodit të Procedurës Civile në Shqipëri parashikon se çdo palë e interesuar ka të drejtën të kërkojë, me anë të një padie në gjykatë, vërtetimin e faktit për të cilin provat dokumentare janë zhdukur ose kanë humbur dhe nuk mund të krijohen përsëri apo të përftohen në ndonjë mënyrë tjetër, nëse një fakt i tillë lidhet me një të drejtë personale ose pronësie. Sipas nenit 390, kërkesa për njohjen e një fakti shqyrtohet nga një gjykatë rrethi në një seancë gjyqësore, në praninë e të gjitha palëve që kanë interes në këtë çështje. Sipas nenit 391, vendimi i gjykatës së rrethit mund të apelohej nga çdonjëra prej palëve në procedura. Vendimi i gjykatës nuk ka “vlerë provuese” për personat që nuk kanë qenë palë në procedura.

II. LIGJI PËR AVOKATURËN E SHTETTIT (LIGJI NR. 10018, I DATËS 13 NËNTOR 2008)

42. Pjesa përkatëse e nenit 5 § 1 (e) e ligjit parashikon se Avokatura e Shtetit ka të drejtën të ndërmarrë procedura për të kërkuar rishikimin e vendimeve të formës së prerë, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në ligjet procedurale përkatëse.

III. KUADRI LIGJOR PËRKATËS PËR RIKTHIMIN E PRONËS

A. Krijimi i komisioneve të pronave – Ligji për Pronat 1993

43. Ligji për Pronat i vitit 1993 (ligji nr. 7698, i datës 15 prill 1993, i ndryshuar) ishte ligji fillestar që kontrollonte rikthimin e pronave të shpronësuara gjatë regjimit komunist në Shqipëri (shih *Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 10508/02, § 37-38, 23 tetor 2007). Vendimet për kërkesat për rikthimin e pronave merreshin nga komisionet vendore për rikthimin dhe kompensimin e pronave, të krijuar sipas atij ligji.

B. Komisioni Shtetëror – Ligji për Pronat 2004

44. Ligji i sipërpërmendur u shfuqizua dhe u zëvendësua nga Ligji për Pronën 2004 (ligji nr. 9235, i datës 29 korrik 2004), që parashikon në nenet 15 dhe 17 se vendimet e komisioneve lokale mund të apeloreshin pranë Komisionit Shtetëror për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave.

C. Krijimi i Agjencisë – ndryshimi i vitit 2006

45. Më 17 korrik 2006, Ligji për Pronën u ndryshua me anë të një ndryshimi në vitin 2006 (ligji nr. 9583), që hyri në fuqi më 17 gusht 2006. Ndryshimi i vitit 2006 parashikonte krijimin e Agjencisë për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave, një organ i ri me zyra rajonale dhe një zyrë qendrore, duke zëvendësuar komisionet lokale dhe Komisionin e Shtetit, respektivisht.

D. Apelimet në Agjenci – ndryshim i vitit 2007

46. Më 6 shkurt 2007, Ligji për Pronën 2004 u ndryshua përsëri me anë të një ndryshimi të vitit 2007 (ligji nr. 9684). Veçanërisht, neni 18 i ligjit u riformulua për tri pika kryesore.

47. Së pari, Avokaturës së Shtetit i lejohej të paraqiste një ankesë pranë zyrës qendrore të Agjencisë ndaj vendimeve të degëve rajonale të Agjencisë, brenda tridhjetë ditëve nga dita e njoftimit.

48. Së dyti, Avokaturës së Shtetit i lejohej të paraqiste ankesë pranë zyrës qendrore të Agjencisë ndaj vendimeve të ish-komisioneve. Për këto ankesa nuk parashikohej asnjë afat kohor.

49. Së treti, drejtorit të agjencisë qendrore i lejohej të shqyrtonte, dhe me mundësi të anulonte, me nismën e tij, vendimet e ish-komisioneve të pronave dhe degëve rajonale të Agjencisë. Për këtë shqyrtim nuk parashikohej asnjë afat kohor.

E. Ankesa pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë – ndryshim i vitit 2009

50. Më 23 dhjetor 2009, Ligji për Pronën 2004 u ndryshua përsëri me anë të ligjit nr. 10207. Ndryshimi riformuloi nenin 18 si më poshtë vijon:

“Kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.”.

IV. PRAKTIKA GJYQËSORE KUSHTETUESE

51. Më 26 Mars 2009, Gjykata e Lartë paraqiti pranë Gjykatës Kushtetuese një kërkesë për vendimmarrje paraprake për kushtetueshmërinë e pushtetit të Agjencisë për shqyrtimin e vendimeve të mëparshme të rikthimit dhe kompensimit me mocionin e saj (shih paragrafin 49 më sipër).

52. Më 26 maj 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi se pushteti i Agjencisë për të shqyrtuar vendimet me mocionin e saj ishte jokushtetues.

53. Ajo arsyetoi se një kërkesë e paraqitur pranë një komisioni të pronës ishte ekuivalent me një padi paraqitur në gjykatë, dhe për këtë arsye vendimet e komisioneve krijonin të njëjtat pritshmëri si edhe vendimet gjyqësore. Ato nuk ishin vetëm akte administrative, por vendime kuazi gjyqësore. Ajo vijonte se vetëm një autoritetet gjyqësor, dhe jo një autoritet administrativ si Agjencia, mund të shqyrtonte një masë për shqyrtimin e një vendimi të komisionit të pronave.

54. Gjykata Kushtetuese shtonte se në mungesë të një ankese, vendimet e komisioneve të pronave bëheshin të formës së prerë dhe detyrues për palët në procedime dhe të zbatueshme sipas ligjit, si vendimet gjyqësore.

55. Për sa u përket meritave të një mase për shqyrtim, gjykata iu referua *Brumărescu kundër Rumanisë* [(DHM), nr. 28342/95, GJEDNJ 1999-VII] dhe gjykonte se nëse një palë, duke përfshirë një autoritet shtetëror, do të shqyrtonte një vendim të formës së prerë vetëm sepse nuk ishte i kënaqur me rezultatin, kjo do të ishte në kundërshtim me kërkesat.

56. Pas vendimit të mësipërm, më 22 korrik 2010, Parlamenti miratoi ndryshimet në Ligjin për Pronën 2004, ku riktheheshin pushtetet e agjencisë qendrore për të shqyrtuar vendimet e mëparshme të komisioneve. Më 6 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese konstatoi, përsëri, se këto parashikime ishin jo kushtetuese, kryesisht për të njëjtat arsye si ato të përshkruara më sipër. Veçanërisht, gjykata gjykoi se rishikimi i një vendimi të formës së prerë të komisionit ishte i ngjashëm me një mjet të jashtëzakonshëm për shqyrtimin e një vendimi civil ose penal të formës së prerë.

LIGJI

I. LOCUS STANDI I TRASHËGIMTARËVE TË KËRKUESIT

57. Gjykata vëren se më 8 nëntor 2021, trashëgimtarët e kërkuarit, znj. Hysnie Mahmuti, znj. Melaize Ruli dhe znj. Lale Meçi, shprehën dëshirën e tyre për të vijuar me procedimet në emër të kërkuarit.

58. Në çështje të ndryshme, kur kërkuari ka ndërruar jetë gjatë procedurave të Konventës, Gjykata merr në konsideratë deklaratat e trashëgimtarëve të kërkuarit ose të familjarëve të afërt që shprehin dëshirën të ndjekin procedurat pranë saj. Gjykata ka pranuar se i afërmi ose trashëgimtari, në parim, mund të ndjekë kërkesën, nëse ai ose ajo ka mjaftueshëm interes për çështjen (shih *Tagiyev dhe Huseynov kundër Azerbajxhanit*, nr. 13274/08, § 24, 5 dhjetor 2019, me referenca të tjera).

59. Sipas sa më sipër, dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata pranon se znj. Hysnie Mahmuti, znj. Melaize Ruli dhe znj. Lale Meçi, kanë interes legjitim në ndjekjen e kërkesës në vend të kërkuarit (krahaso *Alasgarov dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit*, nr. 32088/11, § 25, 10 nëntor 2022). Megjithatë, për arsye lehtësuese, teksti në këtë vendim do të vijojë t'i referohet z. Hasan Gaba si "kërkuari", edhe pse trashëgimtarët e sipërpërmendur konsiderohen të kenë statusin e kërkuarve përpara Gjykatës.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

60. Kërkuari u ankua për shkelje të parimit të sigurisë juridike sipas nenit 6 § 1 të Konventës si rezultat i anulimit të vendimit të vitit 2006 nga autoritetet vendase. Për sa ka të bëjë me çështjen, neni 6 § 1 parashikon si më poshtë:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ... në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ...".

A. Qëllimi i ankesës

61. Gjykata vëren se përpara vendimit të vitit 2006, vendimi i vitit 2003 përmbante po ashtu një sërë konkluzioneve që u kundërshtuan nga gjykatat vendase.

62. Megjithatë, një sërë aspektesh në lidhje me vendimin e vitit 2003 janë të paqarta për Gjykatën.

63. Së pari, si qeveria edhe kërkuari iu referuan vendimit të vitit 2003, sikur "të njihnin një fakt juridik", që mund të kuptohet si referencë ndaj vendimeve gjyqësore të lëshuara sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Megjithatë, vendimi i vitit 2003 nuk rezulton të ketë përfshirë ndonjë referencë prej atij neni. Gjithashtu, ai përdor termat *paditësi* dhe *i padituri*, dhe jo *kërkuari* dhe *pala e interesuar*, të cilët në përgjithësi janë palët në një vendim të lëshuar sipas nenit 388.

64. Së dyti, qeveria argumentoi se duke pasur parasysh specifikat e tij sipas legjislacionit vendas, vendimi i vitit 2003 gëzonte vetëm autoritet të kufizuar. Kërkuari nuk ra dakord.

65. Sidoqoftë, Gjykata gjykon se në çështjen konkrete nuk është e domosdoshme që të merret vendim për aspektet e mësipërme, sepse materiali në dosjen e çështjes është i mjaftueshëm për të arritur në një përfundim për ankesën. Gjithashtu, në kërkesën e tij pranë Gjykatës, kërkuesi e përqendronte ankesën e tij tek anulimi i vendimit të vitit 2006, dhe jo tek vendimi i vitit 2003, dhe sipas rrethanave, Gjykata do të ndjekë të njëjtën qasje në analizën e saj.

A. Pranueshmëria

66. Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet vendase, pasi ai nuk e kishte ngritur ankesën e tij në thelb pranë Gjykatës Kushtetuese.

67. Gjykata vëren se ankesa kushtetuese e kërkuetit i referohej gjerësisht praktikës gjyqësore vendase, në lidhje me sigurinë juridike dhe pohonte qartësisht se anulimi i vendimit të vitit 2006 shkelte parimin e sigurisë juridike (shih paragrafët 36–39 më sipër).

68. Gjithashtu, qeveria argumentonte se vendimi i vitit 2006 ishte dhënë nga një autoritet administrativ specifik dhe nuk ishte një vendim gjykatë. Sipas rrethanave, në këndvështrimin e qeverisë, çështja konkrete duhet të dallohet nga çështjet që kanë të bëjnë me prishjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

69. Gjykata vlerëson se parashtrimi i qeverisë i referohet zbatueshmërisë *ratione materiae* të nenit 6 § 1 për çështjen konkrete.

70. Më herët, në çështjet kundër Shqipërisë, Gjykata ka konstatuar se një ankesë për moszbatimin e një vendimi të formës së prerë të një komisioni për pronat ishte *ratione materiae* i pajtueshëm me nenin 6 § 1 të Konventës (shih *Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 38222/02, § 37, 13 nëntor 2007). Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimet e komisioneve të pronave nuk ishin thjesht masa administrative, por vendime kuazi gjyqësore (shih paragrafin 53 më sipër). Sipas rrethanave, argumenti i qeverisë rrëzohet.

71. Ankesa nuk është qartazi e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës apo e papranueshme për arsye të tjera. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

72. Kërkuesi parashtroi se vendimi i vitit 2006 ishte bërë i formës së prerë dhe se gjykatat vendase e kishin anuluar në shkelje të parimit të sigurisë juridike. Ai pretendonte se transmetuesi publik nuk kishte të drejta pronësie ndaj tokës, por vetëm një deklaram – një deklaram që, më së shumti, kishte të bënte vetëm me një pjesë të asaj toke.

73. Qeveria u përgjigj se transmetuesi publik nuk kishte qenë palë në procedurat e vitit 2006 pranë Komisionit. Për këtë arsye, efekti *res judicata* i vendimit të tij nuk ishte zbatuar për transmetuesin publik, që më pas kishte pasur të drejtën të kundërshtonte vendimin e vitit 2006 pa shkelur parimin e sigurisë juridike ose parimin *res judicata*.

74. Qeveria shtoi se vendimi i vitit 2006 nuk kishte qenë i formës së prerë dhe se miratimi i ndryshimit të vitit 2007 ndaj Ligjit të Pronës 2004, që shërbente si bazë për shqyrtimin e vendimeve të ish-komisioneve të pronave (shih paragrafin 48 më sipër), ishte bërë i nevojshëm për shkak të abuzimeve që ishin vërejtur në lidhje me proceset e rikthimit të pronës. Qeveria përfundonte me parashtrimin se vendimi ishte anuluar në përputhje me ligjin vendas.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme

75. Gjykata përsërit se e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës, interpretuar sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike, përfshin kërkesën se në rastin kur gjykatat kanë marrë vendim të formës së prerë për një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pyetje (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson* cituar më sipër, § 28).

76. Sipas këtij parimi, asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë dhe detyrues thjesht me qëllimin për të pasur një seancë gjyqësore dhe një vendim të ri për çështjen. Shqyrtimi nuk duhet të kthehet në një ankesë nën maskim. Parimi i sigurisë juridike dikton se në rastin kur një mosmarrëveshje civile shqyrtohet për meritat nga gjykatat, vendimi duhet të merret një herë dhe përgjithmonë, dhe një distancim nga ky parim justifikohet vetëm kur është e nevojshme nga rrethanat me një karakter thelbësor dhe detyrues, të tilla si korrigjimi i defekteve themelore ose dështimi i drejtësisë (shih, për shembull, *Gražulevičiūtė kundër Lituanisë*, nr. 53176/17, §§ 73, 80 dhe 82, 14 dhjetor 2021, me referenca të tjera).

b) Zbatimi i parimeve

i. Efektet e vendimit të vitit 2006 ndaj transmetuesit publik

77. Si përgjigje ndaj argumentit të qeverisë (shih paragrafin 73 më sipër), Gjykata vëren se vendimi i agjencisë, i vitit 2010, i referohet transmetuesit publik me të drejta ndaj një pjese të tokës. Në të njëjtën kohë, mbivendosja midis pronës së kërkuarit dhe pronës së transmetuesit publik ishte vetëm i pjesshëm, dhe në këtë mënyrë nuk mund të justifikonte anulimin e vendimit të vitit 2006 për të gjithë sipërfaqen e tokës (shih paragrafin 22 më sipër).

78. Gjithashtu, së fundmi, as Gjykata e Rrethit Tiranë dhe as Gjykata e Lartë nuk iu referuan të drejtave të transmetuesit publik ndaj pjesës së tokës ose ndonjë interesi tjetër publik detyrues për të anuluar vendimin e vitit 2006. Sidoqoftë, gjykatat iu referuan faktit se kërkuari nuk paraqiti mjaftueshëm prova që tregonin se babai i tij e kishte zotëruar më parë tokën (shih paragrafët 26–28 dhe 32–33 më sipër).

79. Për këtë arsye, çështja përpara Gjykatës nuk është se deri në çfarë mase vendimi i vitit 2006 pati efekt *res judicata* ndaj transmetuesit publik. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse vendimi i vitit 2006 ishte i formës së prerë dhe, nëse po, nëse shqyrtimi i tij përjashtimor dhe rrëzimi i tij u bënë të detyrueshëm nga rrethanat e një karakteri thelbësor dhe detyrues, ose nëse shqyrtimi solli rigjykimin e çështjes (shih paragrafin 76 më sipër). Gjykata do t'i adresojë këto çështje me radhë.

ii. Nëse vendimi i vitit 2006 ishte i formës së prerë

80. Gjykata e Lartë deklaroi se vendimi i vitit 2006 nuk ishte bërë i formës së prerë (shih paragrafin 33 më sipër), pa ofruar një arsyetim të qartë për sa ka të bëjë me shkaqet ligjore që çuan në atë përfundim. Qeveria e mbështeti atë përfundim në parashtrimet e saj përpara Gjykatës.

81. Gjykata nuk mund të pajtohet me atë argument, pasi ka një sërë elementesh që nuk ishin adresuar nga Gjykata e Lartë, dhe që çojnë në përfundimin e kundërt. Veçanërisht seksioni 5 i klauzolës operative i vendimit të vitit 2006 parashikonte një afat tridhjetëditor brenda së cilit mund të paraqiten ankesa ndaj tij, dhe klauzola përfundimtare në vendim shpreh qartazi se nuk është paraqitur asnjë apelim brenda atij afati (shih paragrafin 14 më sipër). Në fakt, në periudhën dyvjeçare pas miratimit të vendimit të vitit 2006, rezulton të mos jetë marrë asnjë masë tjetër ndaj tij.

82. Pas më shumë se dy vitesh, transmetuesi publik i kërkoj Avokaturës së Shtetit të kundërshtonte vendimin e vitit 2006, sipas nenit 5, të Ligjit për Avokatin e Shtetit, një dispozitë e përgjithshme që i lejon të kundërshtojë “vendimet e formës së prerë”, në përputhje me rregullat e përgjithshme për shqyrtimin e vendimeve përfundimtare (shih paragrafët 18 dhe 42 më sipër). Kjo sugjeron se transmetuesi publik e kishte konsideruar vendimin e vitit 2006 si të formës së prerë.

83. Gjithashtu, në seksionin e ligjit të zbatueshëm të vendimit të saj, Gjykata e Lartë citonte nenin 18 të Ligjit të Pronës 2004 (ndryshuar dhe miratuar në dhjetor 2009 – shih paragrafët 34 dhe 50 më sipër), që e lejonte Avokatin e Shtetit të kundërshtonte vendimet e Agjencisë brenda tridhjetë ditëve që prej njoftimit. Megjithatë, kjo dispozitë nuk ishte në fuqi në kohën kur Avokati i Shtetit e kishte depozituar ankesën e tij në agjenci (shih paragrafin 19 më sipër). Gjithashtu, nuk është e qartë se gjykata e kishte zbatuar nenin 18 të ndryshuar në çështjen konkrete, pasi neni parashikon në lidhje me kundërshtimet ndaj vendimeve të Agjencisë dhe nuk përmend vendimet e ish-komisioneve. Së fundmi,

nuk është e qartë se si është përlogaritur afati tridhjetëditor, pasi vendimi i kundërshtuar u shpall më 20 shkurt 2006 dhe kundërshtimi i Avokatit të Shtetit u dorëzua më 7 maj 2009 (shih paragrafët 13 dhe 19 më sipër).

84. Rezulton se në periudhën e paraqitjes së ankesës së tij ndaj vendimit të vitit 2006, Avokati i Shtetit ishte mbështetur në një klauzolë tjetër të nenit 18 të ndryshuar në Ligjin për Pronën 2004, që e lejonte Avokatin e Shtetit të kundërshtonte vendimet e formës së prerë të ish-komisioneve pa kufij kohorë ose thelbësorë (shih paragrafin 48 më sipër). Një dispozitë e tillë legislative e pacilësuar ngre pyetjet e qarta në lidhje me respektimin e sigurisë juridike. Kjo dispozitë u shfuqizua në fund të vitit 2009 me anë të ligjit nr. 10207; si rezultat, Avokatura e Shtetit gëzoi për pothuajse tri vite fuqi shumë të gjera për të kundërshtuar pushtetin *res judicata* në kontekstin e rikthimit, pa ndonjë udhëzues apo kufizime të qarta legislative në lidhje me përdorimin nga ana e saj të fuqive për shqyrtim. Gjatë po kësaj periudhe u mor masa me ndikim ndaj kërkuessit.

85. Për sa më sipër, Gjykata nuk mund të bjerë dakord me pohimin se vendimi i vitit 2006 nuk ishte bërë i formës së prerë dhe ishte ndryshuar me anë të një anekse të zakonshme. Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 52–56 më sipër), Gjykata vlerëson se vendimi i vitit 2006 është bërë i formës së prerë dhe se kundërshtimi i tij përbënte një mjet të jashtëzakonshëm.

iii. Nëse ekzistonin rrethanat thelbësore dhe detyruese për shqyrtim

86. Në lidhje me argumentin e qeverisë për nevojën për të shqyrtuar vendime të caktuara abuzive të komisioneve të pronës, në të shkuarën Gjykata ka gjykuar se fuqitë e gjykatave më të larta për të prishur ose ndryshuar vendime gjyqësore detyruese dhe të zbatueshme duhet të ushtrohen me qëllimin për të korrigjuar gabimet dhe dështimet gjyqësore të drejtësisë, por jo për të realizuar një shqyrtim të ri (shih *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ 2003-IX). Ky pushtet duhet të ushtrohet për të arritur në maksimumin e mundshëm një balancë të drejtë midis interesave të një individi dhe nevojës për të siguruar efektivitet në sistemin e drejtësisë (shih *Giuran kundër Rumanisë*, nr. 24360/04, § 30, GJEDNJ 2011 (ekstrakte)).

87. Më herët, Gjykata ka konstatuar se një defekt themelor në procedime, si për shembull një gabim juridiksional, shkelje të rënda të procedurës gjyqësore, abuzimi me pushtetin, manifestimi i gabimeve në zbatimin e ligjit thelbësor ose çdo arsye tjetër e rëndësishme që buron nga interesat e drejtësisë, në parim, mund të justifikojë distancimin nga parimi i sigurisë juridike (shih, në kontekstin e procedurave civile, *Tolstobrov kundër Rusisë*, nr. 11612/05, §§ 17–20, 4 mars 2010; *Tishkevich kundër Rusisë*, nr. 2202/05, §§ 23–27, 4 dhjetor 2008; *Protsenko kundër Rusisë*, nr. 13151/04, §§ 25–34, 31 korrik 2008; *Luchkina kundër Rusisë*, nr. 3548/04, § 21, 10 prill 2008; dhe *Sharra kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 29975/06, §§ 46–53, 6 dhjetor 2011).

88. Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata përsërit se në periudhën përkatëse pushteti i Avokatit të Shtetit për të kundërshtuar vendimet e ish-komisioneve të pronës nuk ishte i kufizuar në kohë (shih paragrafin 48 më sipër). Një kuadër kohor i pakufizuar për marrjen e një mase të tillë nuk mund të konsiderohet i pranueshëm nga këndvështrimi i afateve kohore, dhe pajtueshmëria me kërkesat e qartësisë procedurale dhe parashikueshmërisë së realizimit të procedurave, që janë çështje të rëndësishme madhore sipas nenit 6 § 1 të Konventës (shih, *mutatis mutandis*, *Salov kundër Ukrainës*, nr. 65518/01, § 96, GJEDNJ-VIII (ekstrakte)).

89. Gjithashtu, rezulton se Avokati i Shtetit mund të kërkojë shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të një ish-komisioni të pronës për çdo arsye juridike të një natyre të përgjithshme, dhe jo për rrethana thelbësore dhe detyruese (shih, *Gražulevičiūtė kundër Lituanisë*, cituar më sipër, §§ 73, 80 dhe 82, dhe *Ryabykh*, cituar më sipër, § 52).

90. Në të vërtetë, Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Lartë arritën në përfundimin se kërkuessi nuk kishte mundur të provonte se babai i tij e kishte zotëruar token (shih paragrafët 28 dhe 32 më

sipër), pa konsiderata të mëtejshme, në lidhje me ndonjë defekt thelbësor në procedurat e mëparshme ose me mungesën e konsideratave ndaj interesave publikë në procesin e rikthimit.

91. Gjykatat nuk theksuan emergjencën e ndonjë prove ose nuk hodhën dyshime për vërtetësinë e provave që tashmë ishin në dosjen e çështjes. Në thelb, ato rishqyrtuan faktet ekzistuese dhe të njohura që tashmë ishin shqyrtuar nga Komisioni, dhe përdorën diskrecionin e tyre për të arritur një konkluzion të kundërt me atë të arritur nga një vendim i Komisionit për të cilin Gjykata gjykoj se ishte përfundimtar (shih paragrafin 85 më sipër; shih, gjithashtu, edhe *Solomun kundër Kroacisë*, nr. 679/11, § 55, 2 prill 2015).

92. Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se ka pasur rrethana thelbësore dhe detyruese që justifikojnë anulimin e vendimit të vitit 2006.

iv. Përfundim

93. Sipas rrethanave, është shkelur neni 6 § 1 i Konventës për sa i përket anulimit të vendimit të vitit 2006 të komisionit për rikthimin e pronës pa rrethana thelbësore dhe detyruese që e justifikojnë atë masë.

III. ANKESA TË TJERA

94. Kërkuesi u ankua se anulimi i vendimit të vitit 2006, dhe revokimi i titullit të tij të pronësisë ndaj pronës, kishte shkaktuar shkeljen e nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës. Për sa i përket fakteve të çështjes, parashtrimeve të palëve, dhe gjetjeve të saj më sipër, Gjykata vlerëson se ajo ka trajtuar çështjet kryesore juridike të çështjes, dhe se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pjesa tjetër e ankesave (shih *Qendra për Burimet Juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

95. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

96. Kërkuesi nuk kërkoi ndonjë shumë për dëmin pasuror ose për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendase, për këtë arsye Gjykata nuk bën asnjë akordim për këto kategori.

97. Kërkuesi kërkoi 10,000 euro (EUR) për dëmin jopasuror, dhe EUR 4,115 për kostot dhe shpenzimet e bëra në Gjykatë.

98. Qeveria i kundërshtoi këto kërkesa si të pajustificuara.

99. Gjykata i akordon kërkuesit EUR 3,600 për dëmin jopasuror plus çdo taksë të tarifueshme.

100. Duke pasur në konsideratë dokumentet në zotërimin e saj, Gjykata e konsideron të arsyeshme t’i akordojë kërkuesit EUR 3,500 për kostot dhe shpenzimet në lidhje me procedurat pranë saj, plus çdo taksë që mund t’i tarifohet atij.

101. Së fundmi, Gjykata vëren se ligji vendas parashikon mundësinë e rihapjes së procedurave gjyqësore për çështjet ku Gjykata ka konstatuar një shkelje të Konventës (shih *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, §§ 56–57, 4 tetor 2022). Sipas rrethanave, forma më e përshtatshme për korrigjim për kërkuesin do të ishte rihapja e procedurave, nëse kërkuesi e kërkon një gjë të tillë, dhe rishqyrtimi i çështjes në një mënyrë të tillë që është në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *Gjykon* se znj. Hysnie Mahmuti, znj. Melaize Ruli dhe znj. Lale Meçi kanë të drejtë të ndjekin kërkesën;

2. *E shpall* ankesën të pranueshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës;

3. *Gjykon* se është shkelur parimi i sigurisë juridike sipas nenit 6 § 1 të Konventës nga ana e autoriteteve vendase që kanë anuluar vendimin e vitit 2006 të komisionit për rikthimin e pronës në favor të kërkuarit;

4. *Gjykon* se nuk është e nevojshme që ankesa e kërkuarit të shqyrtohet në mënyrë të veçantë sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1;

5. *Gjykon*:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

i. EUR 3,600 (tre mijë e gjashtëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet për dëmin jopasuror;

ii. EUR 3,500 (tre mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara Gjykatës;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në shlyerje interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindje.

6. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuarit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 17 dhjetor 2024, në mbështetje të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Ioannis Ktistakis
KRYETAR